

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri**

Prizren, më 07.02.2020

Në mbështetje të nenit 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më, 31.01.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani Strategjik i Ndërkombëtarizimit 2020 - 2024.
- II. Plani Strategjik i Ndërkombëtarizimit 2020 - 2024, do të rishikohet çdo vit, Këshilli Drejtues do të konsultohet me Ministrinë përkitazi me përputhjen e objektivave dhe të planeve të veta me Strategjinë shtetërore për arsimin e lartë dhe të burimeve që do të jenë në dispozicion nga Ministria.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë Plani Strategjik i sipërsëhënuar.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Plani Strategjik për Ndërkombëtarizimin e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren është produkt i një procesi gjithëpërfshirës të konsultimit me akterët e jashtëm dhe të mbrendshëm të Universitetit dhe është hartuar duke u mbështetur në Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit, Standartet dhe Udhëzuesit e Agjencisë Kosovare dhe Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtarë.


Në këtë Plan strategjik për Ndërkombëtarizimin e Universitetit janë identifikuar objektivat afatmesme dhe afatgjata të cilat e orientojnë Universitetin në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave për ndërkombëtarizim.

Të bindur që ky Plan Strategjik synon të zhvilloj procesin e ndërkombëtarizimit të stafit akademik dhe studentëve, kurrikulave, programeve të studimit dhe kërkimit, anëtarësimin në asociacione ndërkombëtare dhe standartizimin e cilësisë, rrjetizimin akademik e kërkimor

ndërkombëtar si dhe krijimin e profilit ndërkombëtar të Universitetit, Këshilli Drejtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.